



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 89 datë 22.10. 2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.96, DATË 27.11.2024, "PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, BASHKIA PËRMET, VITI 2025".

Në mbështetje të nenit 54, shkronja "f", të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, VKM nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", Paketës Fiskale të vitit 2025, miratuar me vendim nr.96, datë 27.11.2025, Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e taksës së fjetjes në hotel për Bashkinë Përmët, sipas kategorizimit të numrit të shtretërve si më poshtë:

- Hotel, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 1- 10 shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 30 netë fjetje për cdo shtrat.
- Hotel, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 11- 20 shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 45 netë për cdo shtrat.
- Hotel, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 21 e lartë shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 60 netë për cdo shtrat.

2. Të gjitha subjektet akomoduese e kanë të detyrueshëm të bëjnë deklarinimin për numrin e shtretërve dhe rregjistrin të fjetjes në strukturë dhe ta paraqesin atë në Bashkinë Përmet për t'u sekretuar me vulë origjinale të Bashkisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Tatim Taksave, Aseteve dhe licencave pranë Bashkisë Përmet, Njësiti Administrative.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI

